



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 739, datë 9.9.2015

PËR

**DISA SHITESA NË RREGULLOREN E ZBATIMIT TË KODIT
RUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MIRATUAR ME
VENDIMIN NR.153, DATË 7.04.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ë”, të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në rregulloren e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.153, datë 7.04.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

I. Pas nenit 20 shtohet neni 20/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 20/1

Sistemi i të dhënave të aksidenteve rrugore(Neni 11 i Kodit Rrugor)

1. Sistemi i të dhënave të aksidenteve rrugore (SDA) shërben për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, shpërndarjen dhe përdorimin e të dhënave të aksidenteve rrugore në të gjithë rrjetin rrugor shqiptar, si pjesë integrale e sistemit të menaxhimit të sigurisë rrugore.

¹ Ky vendim synon përputhjen e plotë të Vendimit të Këshillit të Bashkimit Evropian Nr. 93/704/EC, datë 30 Nëntor 1993, “Mbi krijimin e një baze të dhënash të komunitetit mbi aksidentet rrugore” Dokument 31993D0704; OJ No L 329/63

2. Ky sistem është ndërtuar mbi bazën e një programi kompjuterik *Microsoft Office Acces* dhe shoqërohet nga manuali i përdorimit (manuali për futjen e të dhënave dhe manuali për analizën e të dhënave), që i bashkëlidhet rregullores.
3. Mbledhja e të dhënave bëhet nga shërbimet e policisë rrugore që operojnë në vendngjarje, duke plotësuar formularin e miratuar të aksidentit (Shtojca 1. Raporti i aksidentit rrugor). Pasi kontrollohen, të dhënat e hedhura i dërgohen Drejtorisë së Policisë Rrugore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në formë elektronike, brënda ditës, ndërsa raportet e aksidenteve të muajit dërgohen brenda datës 5 të muajit pasardhës.
4. Drejtoria e Policisë Rrugore, pasi kontrollon të dhënat e administruara zyrtarisht me ato të dërguara në rrugë elektronike gjatë muajit, duke rakorduar me të dhënat e urgjencave shëndetësore të Spitalit të Traumës Tiranë, të emergjencave civile, mjekësisë ligjore, enteve pronar të rrugës dhe autoritetit të sigurimeve, ia dërgon ato, në rrugë elektronike, brenda datës 10 të muajit pasardhës, Drejtorisë së qarkullimit dhe sigurisë rrugore në ministrinë përgjegjëse për transportin.
5. Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore, mbështetur në programin SDA, përpunon të dhënat e marra nga Policia Rrugore dhe bën analizën e shkaqeve të ndodhjes së aksidenteve rrugore, me qëllim që ato të përdoren:
 - nga Policia Rrugore, për ndërmarjen e veprimeve për përmirësimin e sigurisë rrugore në ato vende ku kanë ndodhur aksidente rrugore;
 - nga vetë Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore, për përcaktimin e pikave të zeza dhe krijimin e hartës digjitale;
 - nga autoritetet përgjegjëse të rrugëve, për marjen e masave në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, kur kjo dëmtohet, si dhe në përmirësimin e pikave të zeza;
 - nga organizma të tjera, të përfshira në sigurinë rrugore, për hartimin e planeve të veprimit dhe zbatimin e tyre, me qëllim përmirësimin e situatës.”

II. Në fund të rregullores shtohet manuali i përdorimit (manuali për futjen e

të dhënave dhe manuali për analizën e të dhënave), që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

**MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS**

EDMOND HAXHINASTO

¹ Ky vendim synon përputhjen e plotë të Vendimit të Këshillit të Bashkimit Evropian Nr. 93/704/EC, datë 30 Nëntor 1993, “Mbi krijimin e një baze të dhënash të komunitetit mbi aksidentet rrugore” Dokument 31993D0704; OJ No L 329/63